




**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**



**RAPORT I INSPEKTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM  
“VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË STACIONEVE POLICORE NË  
SKENDERAJ, PODUJEVË DHE OBILIQ”**

**Nr. 2/2021**

**Prishtinë, 20 prill 2021**

## Informata të përgjithshme

---

<b>Titulli</b>	Raport i inspektimit të jashtëzakonshëm Vlerësimi i performancës së stacioneve policore në Skenderaj, Podujevë dhe Obiliq
<b>Data e përgatitjes</b>	20 prill 2021
<b>Realizuar nga</b>	Kadri Keçmezi, inspektor, Kushtrim Jonuzi, inspektor, Mirsad Puçurica, inspektor, Servet Tasholli, inspektor, Xhavit Fetahaj, inspektor
<b>Mbikëqyrur nga</b>	Ilir Idrizaj, udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit,
<b>Mbështetur nga</b>	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
<b>Dorëzuar nga</b>	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
<b>Miraturar nga</b>	Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv, Inspektorati Policor i Kosovës
<b>Data e miratimit</b>	20 prill 2021



## Përmbajtja

---

- 1. Përmbledhja ekzekutive**
  - 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-4)
- 2. Hyrje**
  - 2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....(5-5)
  - 2.2. Qëllimi i inspektimit.....(5-5)
  - 2.3. Objekti dhe subjekti i inspektimit.....(5-5)
  - 2.4. Objektivat e inspektimit.....(5-5)
  - 2.5. Rëndësia e inspektimit.....(5-6)
  - 2.6. Metodologjia e inspektimit.....(6-6)
  - 2.7. Periudha e realizimit dhe mbulimit të inspektimit.....(6-6)
  - 2.8. Drejtimit e inspektimit.....(6-6)
  - 2.9. Kriteret e vlerësimit.....(6-6)
  - 2.10. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(6-6)
- 3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet**
  - 3.1 Performanca e Stacionit Policor në Skenderaj.....(7-11)
  - 3.2 Performanca e Stacionit Policor në Podujevë.....(11-15)
  - 3.3 Performanca e Stacionit Policor në Obiliq.....(15-18)
- 4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve**
  - 4.1 Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(19-24)

## 1. Përmbledhja ekzekutive

---

### 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Stacionet policore në Skenderaj, Podujevë dhe Obiliq ende nuk kanë të stabilizuar strukturat e tyre me burime njerëzore, ngase janë identifikuar tejkalime dhe mungesa të numrit të punonjësve brenda gradave, mospërputhje gradë - pozitë ku punonjës me grada më të ulëta ushtrojnë detyra në pozita më të larta (5 raste). Nuk janë hasur raste të ushtrimit të detyrave nga ushtruesë detyre. Janë hasur punonjës të pasistemuar (shërbyes civil), që punojnë në aktivitete tjera administrative në kuadër të stacioneve. Në ditën e inspektimit kapacitetet aktive të stacioneve kanë arritur nga 76% deri në 90% të kapaciteteve të planifikuara, meqenëse pjesa tjetër përfshinë kapacitete pasive të stacioneve që në momentin e inspektimit janë hasur në pushime mjekësore, vjetore, etj.

1.1.2. Stacionet kanë pasur në fuqi një numër planesh operative, përfshirë edhe atë mbi zbatimin e masave kundër Covid-19. Patrullat policore janë verifikuar gjatë natës dhe ditës dhe janë hasur duke operuar në kuadër të planeve e orarëve. Një stacion policor ka nevojë të konsolidojë evidencat mbi vijueshmërinë në punë. Nga logjet e raportimeve ditore dhe raportet fillestare të incidenteve është nxjerrë koha e reagimit të njërive policore në vendngjarje për tre stacionet policore, e cila sillet të jetë nga 12-17 minuta nga momenti i raportimit. Dy (2) nga tre (3) stacionet e inspektuara kanë shënuar rënie në zbulueshmërinë e rasteve në vitin 2020 krahasuar me një vit më parë. Niveli i zbulueshmërisë së rasteve për tre stacionet, në vitin 2020 sillet nga 53% deri në 63%. Numri i raporteve inteligjente 5x5x5x në vitin 2020 ka shënuar rënie në dy (2) nga tre (3) stacionet e inspektuara, krahasuar me një vit më parë. Në nivel të tre stacioneve konsiderohet numër i ulët i këtyre informatave kur kihet parasysh se është duke zbatuar Strategjia për Policimin në Bashkësi, e cila promovon bashkëpunimin me qytetarët dhe forumet e sigurisë.

1.1.3. Lidhur me procedimin e rasteve, ato evidentohen në regjistra të veçantë, por janë hasur dhe disa raste kur janë përcjellë me vonesa për regjistrim në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK). Lëndët janë të regjistruara në këtë Sistem dhe më pas iu janë shpërndarë njërive përkatëse. Sa i përket trajtimit të personave të ndaluar, shoqëruar apo të ndaluar përkohësisht, në ditën e inspektimit është vërejtur se vetëm Stacioni Policor në Podujevë ka pasur të ndaluar disa persona deri në 48 orë, të cilët nuk kanë shprehur shqetësime mbi trajtimin e bërë nga personeli i stacionit. Dy (2) stacionet tjera në Obiliq dhe Skenderaj shfrytëzojnë hapësirat e stacioneve tjera në Prishtinë dhe Mitrovicë Jug për të mbajtur personat e ndaluar deri në 48 orë. Në asnjërin prej stacioneve nuk janë hasur persona të shoqëruar apo të ndaluar përkohësisht. Inspektorët në Podujevë kanë identifikuar disa vërejtje sa i përket kushteve fizike dhe të sigurisë brenda Qendrës së ndalimit.

1.1.4. Inspektimi i armëve, municionit dhe pajisjeve nuk ka evidentuar ndonjë mangësi evidente, në përjashtim të një rasti kur një zyrtari policor që kishte shkrepur me armë zjarri, municioni ende nuk iu kishte plotësuar. Rasti i tillë ishte raportuar dhe gjendej në shqyrtim e sipër në Komisionin për Shqyrtimin e Përdorimit të Forcës. Sa i përket pajisjeve rezervë dhe shtesë të automjeteve, janë identifikuar disa mungesa, kurse pajisjet për fikjen e zjarrit hasur në disa raste me afat të skaduar. Tek automjetet e inspektuara janë hasur edhe disa mungesa të pajisjeve dhe mjeteve për punë të njërive patrulluese. Përgjithësisht kushtet e sigurisë në objekte vlerësohen të kënaqshme, me gjithë faktin se janë identifikuar aparate për fikje të zjarrit me afat të skaduar. Sistemi i monitorimit ka qenë funksional, sigurimi i objektit ka qenë aktiv me orar ditor, regjistrat e hyrje - daljeve mbahen rregullisht, etj.

## **2. Hyrje**

---

### **2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit**

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Polici, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar një shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Bazuar në legjislacionin aktual, veç inspektimeve që iniciohen bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, IPK zhvillon edhe inspektime të jashtëzakonshme që mund të rrjedhin me kërkesë e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Ministrit të Punëve të Brendshme. Bazuar në këtë, me datën 30 mars 2021, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka kërkuar inicimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar aktivitetet operative, funksionimin dhe menaxhimin e stacioneve policore në Obiliq, Podujevë dhe Skenderaj. Ky inicim ka ardhur me kërkesë të Ministrit të Punëve të Brendshme, z. Xhelal Sveçla. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit paraqet fushë me interes për IPK-në me qëllim të vlerësimit nëse Policia ka kapacitete të mjaftueshme teknike dhe njerëzore për të kryer detyrat në raport me përgjegjësitë e përcaktuara. Inicimi i inspektimit është ndikuar edhe nga nevoja që Policia të sigurohet se burimet e saj janë të orientuara drejt përmbushjes së objektivave, për të siguruar mjedis të qetë dhe të sigurt. Është me rëndësi të konstatohet nëse menaxhimi i burimeve njerëzore, hetimore e operative është në funksion të zbatimit të mandateve ligjore dhe arritjes së objektivave të ligjshme policore.

### **2.2. Qëllimi i inspektimit**

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat policore zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet;
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat policore;
- Që të jepet një opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me performancën e stacioneve;
- Që të identifikoj mangësitë - dobësitë dhe rekomandojë masa për funksionim më të mirë;
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë punës në fusha përkatëse.

### **2.3. Objekti dhe subjekti i inspektimit**

2.3.1. Në këtë inspektim të jashtëzakonshëm është vlerësuar performanca e tre stacioneve policore në Obiliq, Podujevë dhe Skenderaj.

### **2.4. Objektivat i inspektimit**

2.4.1. Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:

- Të vlerësohet organizimi, funksionimi dhe kapacitetet e burimeve njerëzore;
- Të vlerësohen aktivitetet operative (patrulluese dhe hetimore) të stacioneve;
- Të vlerësohen shërbimet logjistike dhe kushtet e sigurisë në kuadër të stacioneve.

### **2.5. Rëndësia e inspektimit**

2.5.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ngritjen e vazhdueshme të performancës së stacioneve në përmbushje të objektivave;

- Ngritjen e cilësisë së shërbimeve policore ndaj taksapaguesve;
- Ngritjen e përgjegjësisë dhe vetëdijes drejt ofrimit të sigurisë për qytetarët.

## **2.6. Metodologjia e inspektimit**

### **2.6.1. Gjatë inspektimit:**

- a) janë zhvilluar takime - intervista me punonjës përgjegjës të strukturës së stacioneve;
- b) janë kryer këqyrje - verifikime të kushteve të sigurisë në stacione policore, automjeteve dhe pajisjeve të zyrtarëve policor, regjistrave dhe dokumenteve që lidhen me aktivitetet;
- c) janë siguruar dhe marrë dëshmi, si: plane, raporte, procesverbale dhe dëshmi tjera.

## **2.7. Periudha e realizimit të inspektimit**

2.7.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datën 01.04.2021 dhe ka përfunduar me datë 04.04.2021. Por verifikimet e nevojshme të dokumentacionit kanë vazhduar edhe ditëve në vijim.

## **2.8. Drejtimet e inspektimit**

2.8.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Organizimi, funksionimi dhe kapacitetet,
- Aktivitetet operative patrulluese dhe hetimore,
- Logjistika dhe kushtet e sigurisë.

## **2.9. Kriteret (standardet) e vlerësimit**

2.9.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave policore:

- Ligji i Policisë;
- Rregullorja për Operativë;
- Procedurat Standarde të Operimit.

## **2.10. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave**

2.10.1. IPK-ja vlerëson se gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk ka hasur në ndonjë vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Programin e punës inspektuese.

### 3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

#### 3.1. Performanca e Stacionit Policor në Skenderaj

3.1.1. Bazuar në Strukturën organizative të datës 28.02.2019, Stacioni Policor në Skenderaj funksionon në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Mitrovicës Jug. Është i kategorizuar si stacion policor i kategorisë B dhe funksionon me tre sektorë: operativë, hetime dhe resurse. Në kuadër të operativës funksionojnë ekipet reaguese A, B, C dhe D, sektorët A, B, C, D dhe Nënstacioni Policor - Syriganë. Stacioni Policor ka Qendrën e Mbajtjes, që për momentin është jofunksionale përshkak të punimeve që janë duke u bërë në të (personat e ndaluar nga punonjësit e stacionit vendosen në Qendrën e mbajtjes në Stacionin Policor të Mitrovicës Jug).

3.1.2. Struktura organizative parasheh që Stacioni Policor në Skenderaj të ketë 96 punonjës, por pas verifikimit të listave të personelit, vërehet se Stacioni në fjalë ka 121 punonjës të uniformuar dhe shërbyesë civil. Stacioni ka numër më të madh të të punësuarve krahasuar me Strukturën e organizative të aprovuar dhe aty vërejmë tejkallim të numrit për një (1) toger, 26 polic dhe një (1) shërbyes civil. Ka mungesë të një (1) kapiteni dhe dy (2) rreshterëve. Nga numri i përgjithshëm prej 121 punonjësish, nëntë (9) prej tyre janë të transferuar përkohësisht në Drejtorinë për Sigurim të Objekteve e Personaliteteve (DSOP) në Prishtinë. Është identifikuar një punonjës i uniformuar me gradë toger që ushtron detyrën në pozitë më të lartë se që parashihet për gradën (komandanti i stacionit është toger dhe ushtron detyrën e kapitenit). Nuk janë hasur raste kur pozitat ushtrohen me ushtrues detyre. Janë hasur dy (2) raste kur shërbyesit civil janë të pasistemuar përshkak se nuk parashihen me strukturë, por që janë të angazhuar në aktivitete tjera në kuadër të stacionit.

<b>Tabela 1 - Pasqyrë tabelore mbi kapacitetet e planifikuara dhe ato aktuale të burimeve njerëzore të Stacionit Policor në Skenderaj (01.04.2021)</b>						
<b>Kategoria</b>	<b>Kapiten</b>	<b>Toger</b>	<b>Rreshter</b>	<b>Polic</b>	<b>Shërbyes civil</b>	<b>Gjithsej</b>
Planifikuar	1	2	12	68	13	96
Aktuale	0	3	10	94	14	121
Ndryshimi	-1	+1	-2	+26	+1	+25

3.1.3. Inspektorët në ditën që kanë realizuar inspektimin kanë hasur se Stacioni ka organizuar orarin e punës varësisht nga natyra e punës së zyrtarëve dhe njërive. Shërbyesit civil punojnë në orarin e rregullt nga ora 08.00 deri në 16.00, kurse sektorët dhe ekipet reaguese punojnë në tre (3) ndërrime: 07.00 - 15.00, 15.00 - 23.00 dhe 23.00 - 07.00. Stacioni ka dy lloj orarësh, mujor dhe atë ditor. Gjatë inspektimit të realizuar në ndërrimin e paraditës së datës 01.04.2021, inspektorët kanë siguruar oraret ditore të angazhimeve policore nga mbikëqyrësi i ndërrimit dhe regjistrat e vijueshmërisë. Inspektorët kanë verifikuar ardhjen në punë, prezencën e personelit në stacion dhe të atij në aktivitete patrulluese dhe hetimore. Sipas vlerësimeve të inspektorëve, nga kapaciteti prej 47 punonjësve sa parashihet të jetë i përfshirë në aktivitet, në ditën e inspektimit kanë qenë aktive 89% e këtyre kapaciteteve (42 punonjës), përshkak se pjesa tjetër ka qenë në mungesë për arsye të ndryshme (5 punonjës). Nga të dhënat e pasqyruara nga stacioni dhe verifikimi i prezencës, nuk është vërejtur të ketë pasur mospërputhje në të dhënat mbi vijueshmërinë, kurse mungesat janë deklaruar dhe vlerësohen të arsyeshme.

Tabela 2 - Pasqyrë mbi kapacitetet aktive të stacionit gjatë ndërrimit A (01.04.2021)						
Kategoria	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Shërbyes civil	Gjithsej
Të parapara	0	2	5	30	10	47
Aktiv	0	2	5	26	9	42
Mungesë	0	0	0	-4	-1	-5

3.1.4. Në drejtimin operacional, inspektorët janë interesuar të njihen me planet operative që janë në zbatim. Inspektorët kanë siguruar se stacioni ka në fuqi gjashtë (6) plane operative që ndërlidhen me urdhrat operativ qendror dhe planet e drejtorive rajonale<sup>1</sup>. Inspektimi ka vënë në pah se Stacioni më 01.04.2021 ka planifikuar edhe aktivitete në mbikëqyrjen e zbatimit të masave kundër Covid-19, pikat e kontrollit, patrullimet e rrugëve dhe shesheve, vizita shkollëve, etj. Fokus i inspektimit ka qenë edhe verifikimi i prezencës së disa prej patrullave policore në lokacionet e planifikuara. Në terren kanë qenë aktive gjithsej gjashtë (6) patrulla policore, me automjete dhe në këmbë. Nga inspektimi i realizuar, një (1) patrullë në ora 12.30 të datës 01.04.2021 është hasur në qytet në rrugën “Azem Bejta” (BF-100/1), kurse një (1) patrullë tjetër është hasur në ora 12.45 në rrugën “Ilaz Kodra” (BF-100/5). Patrulla e tretë policore që është verifikuar në ora 12.00 të datës 02.04.2021 është hasur në Runik (BF-100/2). Inspektorët kanë vlerësuar se patrullat policore janë gjendur në pikat e parapara dhe në përbërje të plotë.

3.1.5. Policia duhet të bëjë përpjekje që kërkesave dhe thirrjeve të qytetarëve t’iu përgjigjet në kohë reale varësisht prioriteteve dhe angazhimeve policore. Sipas Udhëzuesit për zbatimin e monitorimin e programit të besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut, koha e reagimit llogaritet duke filluar nga pranimi i informatës nga Qendra Operative Rajonale Komunikuese (QORK), mbikëqyrësi apo Policia në ndonjërin nga format e komunikimit, koha e dhënies së informatës tek patrulla/njësi të ngarkohet, koha e nisjes së patrullës/njësitit të ngarkuar dhe arritja në vendngjarje. Koha mesatare e reagimit në vendin e ngjarjes për zonën urbane është llogaritur të jetë maksimumi 15 minuta, ndërsa për zonën rurale maksimum 30 minuta, varësisht nga lokacioni ku ndodhë rasti, me përjashtime eventuale në disa zona të thella malore dhe në kushte të papërshtatshme atmosferike<sup>2</sup>. Procedura Standarde e Operimit - Koha e reagimit policor përcakton evidentimin e informatave lidhur me ngjarjet në logun ditor<sup>3</sup>. Qendrat e komunikimit në stacione janë të obliguara për të mbajtur logun ditor të ngjarjeve. Stacioni mban logun ditor të ngjarjeve në formë fizike dhe elektronike. Stacioni praktikon mbajtjen e evidencave mbi kohën e reagimit dhe inspektorët kanë siguruar disa matje mujore që i bëhen këtyre reagimeve. Inspektorët kanë bërë matje të pavarur të kohës së reagimit policor që lidhen me 18 mostra të muajit mars dhe rezulton se koha mesatare e reagimit të njësive policore në vendngjarje lidhur me rastet e raportuara sillet të jetë rreth 17 minuta.

3.1.6. Rregullorja për Personal dhe Administratë në nenin 27 përcakton që për përmbushjen e detyrave në Polici dhe për ushtrimin e autorizimeve policore, punonjësi i Policisë duhet t’i shënojë

<sup>1</sup> Planet Operative: “Parandalimi i kontrabandës”, “Kulti”, “Parandalimi i grabitjeve 2021”, “Ngritja e masave të sigurisë në zonat me popullatë të përzier”, “Unaza e çelikut” dhe Urdhri Operativ për Gadishmëri dhe Reagim për Corona Virusin Covid-19.

<sup>2</sup> Departamenti për Operacione, PSO - Koha e reagimit policor, ref. DDO-04/085/2018, datë 07.09.2018.

<sup>3</sup> Logu ditor është pasqyrë e krijuar elektronike apo me shkrim, në të cilin duhet evidentuar informimet telefonike zyrtare të pranuar nga cilido informues të mundshëm për një rast apo ngjarje e caktuar të ndodhur më parë apo që është në zhvillim e sipër dhe po ashtu në log evidentohen edhe të gjitha informatat e pranuar në mënyra tjera të informimit për të cilat vlerësohen nëse janë të rëndësishme së veçantë.



ato në raport, t'i dorëzojë te mbikëqyrësi i parë në strukturën komanduese të Policisë, në formularin përkatës për këtë, i cili formular do të shërbej si dokumentim i veprimit të ndërmarrë. Inspektorët kanë pasur interesim të njihen me procesin e raportimit të aktiviteteve brenda ndërrimit dhe për ndërrimin. Policia praktikon raportimin në fund të aktivitetit policor, kurse mbikëqyrësi raportet e të gjitha njësive i përmbledhë në një raport, i cili me raportet e ndërrimeve tjera bëhet pjesë e raportit 24 orësh. Inspektorët kanë siguruar raportin e ndërrimit paraprak meqë ndërrimi i hasur ende nuk kishte përfunduar aktivitetin e planifikuar me orar. Po ashtu, është siguruar edhe raporti 24 orësh i situatës ditore për datën 31.03.2021. Është verifikuar përputhja e shënimeve ndërmjet raportit të ndërrimit dhe raportit 24 orësh të situatës ditore dhe vlerësohet se informatat e raporteve të ndërrimeve përfshihen në raportin 24 orësh. Raporti 24 orë i situatës ditore pasqyron ndodhjen e tre (3) incidenteve kriminale në zonën e përgjegjësisë së Stacionit, shqiptimin e dy (2) gjobave për kundërvajtje në trafik dhe një (1) gjobe për moszbatim të masave kundër Covid-19.

3.1.7. Lidhur me procedimin e lëndëve - rasteve, inspektorët janë interesuar të ndjekin procedurën siç e përcakton Procedura Standarde e Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit. Ky dokument në kapitullin IV, pika 2 pasqyron mënyrën se si duhet kaluar lënda nga patrulla, tek operativa, komandanti i stacionit, zyrtari i SIPK-ut dhe njësia përkatëse e hetimeve.<sup>4</sup> Nga inspektimi i 18 mostrave të raporteve fillestare të incidenteve shihet se të gjitha rastet janë evidentuar në Librin e rasteve. Katër raste janë proceduar me vonesë duke tejkaluar afatin prej 24 orë të dorëzimit nga momenti i raportimit të tij (2021-BF-0098, 2021-BF-0111, 2021-BF-0110 dhe 2021-BF-0109). Meqë lëndët para se të dorëzohen tek njësitë përgjegjëse për hetim, duhet evidentuar në databazën e SIPK-ut, ka qenë interesim i inspektorëve të verifikojnë edhe nëse është kryer një evidentim i tillë. Verifikimi i lëndëve vë në pah se të gjitha lëndët e mostruara figurojnë në bazën e të dhënave të SIPK-ut<sup>5</sup>. Pranim - dorëzimi i rasteve ndërmjet Zyrës së SIPK-ut dhe Sektorit të hetimeve realizohet përmes formularit të veçantë ku nënshkruhen palët. Kurse, Sektori i hetimeve regjistron lëndët në Librin e evidentimit të rasteve të Sektorit të hetimeve.

3.1.8. Krahasimi mbi zbulueshmërinë e rasteve të hapura, qoftë vepra penale apo incidente, gjatë vitit 2019 sillet të jetë rreth 59%, kurse në vitin 2020 shënohet një ngritje e zbulueshmërisë në 63%. Numri i raporteve inteligjente të trajtuara dhe përpunuara nga Zyrtari i inteligjencës, të cilat janë përcjellë më pas tek DIA në vitin 2019 ka qenë 76, derisa në vitin 2020 është 33 sosh. Rënia e numrit të raporteve inteligjente 5x5x5 vlerësohet të ketë ardhur për shkak të situatës së krijuar nga pandemia me Covid-19.

3.1.9. Një nga fushat e inspektimit ka qenë edhe trajtimi i personave të ndaluar përkohësisht deri në gjashtë (6) orë dhe atyre të ndaluar në qendër të ndalimit deri në 48 orë. Gjatë kontrollit të hapësirave që shfrytëzohen për shoqërim apo ndalim të përkohshëm të personave, është vërejtur se ato përbëhen nga dhoma të intervistave ku mund të mbahen të ndaluarit deri në gjashtë (6) orë nën mbikëqyrje të zyrtarëve përgjegjës. Kurse, për personat e ndaluar deri në 48 orë ka qenë në

<sup>4</sup> PSO përcakton se se përveç rasteve urgjente, rasteve që iniciohen brenda 24 orëve (brenda tre ndërrimeve), çdo ditë (përjashtimisht vikendeve dhe festave) në orën 08.30 të mëngjesit dorëzohen në sektorin e operativës, të cilat kontrollohen nga shefi i operativës se a janë kompletuar sipas procedurave të parapara dhe a janë në pajtim me Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe ligjet tjera në fuqi. Nëqoftëse rasti është i kompletuar siç duhet, atëherë i dërgohet komandantit të stacionit apo zëvendësit të tij për nënshkrim. Pas nënshkrimit, rastet merren nga zyrtarët e SIPK-ut, të stacionit, fotokopjohen dhe një kopje mbetet në arkivë (databazë), ndërsa origjinali i dërgohet njësive së hetimeve jo më vonë se në ora 09.00 për çdo ditë pune.

<sup>5</sup> Rastet me nr. 2021-BF-0098, 2021-BF-0104, 2021-BF-0093, 2021-BF-0106 dhe 2021-BF-0102.

funksion më parë Qendra e Ndalimit, por që për momentin është jashtë funksionit deri në përfundimin e punimeve që janë duke u kryer në të. Përgjatë dy ditëve sa është realizuar inspektimi nuk është hasur në këto dy kategori të të ndaluarish, me çka është pamundësuar edhe verifikimi mbi trajtimin e këtyre personave.

3.1.10. Për të verifikuar pajisjen me armë, municion e pajisje tjera policore, si dhe për të vlerësuar përkujdesin policor ndaj tyre, inspektorët kanë realizuar kontroll fizik rastësor në stacion policor. Rregullorja për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës në nenin 134 (Pajisjet policore të autorizuar) përcakton që "punonjësit e Policisë, të cilët kanë autorizime policore, derisa janë në uniformë dhe në kryerje të detyrës duhet t'i bartin pajisjet të cilat janë të autorizuar". Në kuadër të pajisjeve hyjnë: rripi i uniformës dhe pajisjet tjera të cilat barten apo vendosen në rrip<sup>6</sup>. Edhe PSO për Bazën e Logjistikës/Njësinë e Armëve dhe Municionit në kapitullin 4.3 (Dhënia e armëve dhe municionit) përcakton se çdo zyrtar policor pas kryerjes së Akademisë policore ngarkohet me: armën Glock 19, 30 copë municion 9x19 mm, 2 karikatorë, një këllëf, një qeskë dhe mjetet për pastrimin e armës. Gjatë inspektimit të nëntë (9) zyrtarëve policor të rastit në stacion, ka rezultuar se të gjithë kanë qenë të pajisur me armë zyrtare Glock 9x19 me nga dy karikatorë me nga 15 fishekë zyrtar secili (një zyrtar policor ka pasur dy fishekë mangut dhe lidhur me këtë ishte raportuar rasti për shkrepte me armë zjarri dhe pritej që lënda të trajtohet nga komisioni përkatës). Zyrtarët policor kanë qenë të pajisur me qeska për pastrimin e armëve në përjashtim të njërit prej tyre që nuk kishte qenë i furnizuar. Po ashtu, zyrtarët policor kanë qenë të pajisur me sprej kimik OC me afat, shufra dhe pranga të metalta. Rregullorja për Operativë në Policinë e Kosovës në nenin 21 përcakton që "Zyrtari policor duhet të kujdeset që armën zyrtare ta mbajë dhe mirëmbajë në gjendje të rregullt. Zyrtarit policor, pa marrë parasysht a është në kryerje të detyrës apo jo është i obliguar që armën zyrtare ta mbajë të pastër dhe në gjendje të rregullt për përdorim". Inspektimi ka nxjerrë në pah se të gjithë zyrtarët i kanë pasur armët e pastërta dhe të padëmtuara. Drejtuesit e stacionit kanë siguruar dokumente, që pasqyrojnë se në baza periodike realizohen inspektime të armëve, municionit dhe pajisjeve brenda stacionit<sup>7</sup>.

3.1.11. Për nevoja operative, hetimore dhe administrative, Stacioni është i pajisur me gjithsej pesë (5) automjete që fatmirësisht të gjitha janë në funksion. Përmes një verifikimi të shpejtë është hasur në një gjendje të mirë higjienike të tyre. Përmes këtij inspektimi, IPK ka arritur të vlerësojë edhe nivelin e pajisjes së automjeteve me pajisje përcjellëse që parashihen me Ligjin nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, por edhe me udhëzimet administrative të Ministrisë së Infrastrukturës. Mes tjerash, Ligji nr. 05/L-088 në nenin 207 ka paraparë që "automjeti i udhëtarëve, kamioni dhe autobusi gjatë qarkullimit të tyre në trafikun rrugor duhet t'i posedojnë pajisjet rezervë dhe shtesë: poçat rezervë, kutinë e ndihmës së parë, trekëndëshin e sigurisë, pajisjen për tërheqje të mjetit në defekt, jelekun reflektues, ndërsa aparatën për fikje të zjarrit, në rastet kur përdorimi i tij parashihet me ligj. IPK-ja ka konsultuar edhe udhëzimet administrative që ka nxjerrë ministria përgjegjëse. Udhëzimi Administrativ (MI) nr. 04/2016 në nenin 34 (Kontrollimi i pajisjeve të automjeteve)

<sup>6</sup> Pajisjet, të cilat barten apo vendosen në rrip përfshijnë: pistoletën e tipit Glock me këllëf; karikatorin e tipit Glock për municion prej 15 plumbash; shufrën zyrtare me këllëfin e tij të tipit ASP; prangat e metalta dhe këllëfin e prangave; sprejin kimik/ngacmues i autorizuar dhe i dhënë nga Policia, i cili duhet të bartet në fotroll të veçantë; katër mbajtëse të rripit policor, dy prej të cilëve duhet të jenë të vendosur në pjesën e përparme dhe dy në pjesën e prapme të rripit të uniformës; baterinë - llambën ndriçuese dhe mbajtësin e baterisë; radiolidhjen dhe mbajtësin e radiolidhjes.

<sup>7</sup> Stacioni Policor - Skenderaj, *Lista e inspektimit të armëve, municionit dhe pajisjeve tjera të zyrtarëve policor*, datë 28 shkurt 2021.

përcakton se kontrollimi i pajisjeve rezervë dhe shtesë të automjetit përfshinë: çelësin e rrotave, ngritësen mekanike ose hidraulike, gomën rezervë vetëm për atë automjet që është paraparë nga prodhuesi, aparatën e fikjes së zjarrit, trekëndëshin, ndihmën e parë, dritat rezervë dhe pajimet e dimrit-zinxhirët. Gjatë kontrollit të pajisjeve rezervë dhe shtesë në tre (3) automjete të inspektuara, inspektorët kanë plotësuar formularët e verifikimit në prani të personave përgjegjës pjesëmarrës në procesin e verifikimit. Nga kontrolli i automjeteve rezultoi se tre (3) automjetet kanë pasur çelës të rrotave, ngritëse mekanike apo hidraulike, gomë rezervë, aparat për fikje zjarri, trekëndësh, ndihmën e parë dhe jelek reflektues. Është me rëndësi të potencohet se aparatet për fikje të zjarrit kanë qenë me afat të skaduar. Drejtuesit e stacionit policor kanë siguruar dokumente, me të cilat pasqyrojnë se periodikisht realizojnë inspektime të automjeteve<sup>8</sup>.

3.1.12. Pajisjet e patrullave policore të hasura në terren janë element të rëndësishëm dhe ndihmojnë në kryerjen e detyrave. Inspektorët janë interesuar për t'u njohur me gjendjen reale se sa pajisjen patrullat policore me mjete e pajisje pune. Vetëm njëra nga tre patrullat policore të hasura në terren ka qenë e pajisur me matës të shpejtësisë, që paraqet mjetin e vetëm të kësaj natyre në kuadër të stacionit. Stacioni ka pasur tre alkooteste, por që ato nuk janë hasur tek njësitë patrulluese në terren. Stacioni ka pesë (5) kamera (aparate) por që nuk janë hasur tek automjetet e inspektuara. Stacioni ka vetëm pesë (5) kone të trafikut, por që nuk janë gjetur tek asnjëri nga automjetet e inspektuara. Shiriti për kufizimin e vendit të ngjarjes dhe jeleku reflektues është hasur në tre automjete. Metri dhe stopi i dorës është hasur në dy (2) nga tre (3) automjetet e inspektuara. Mungesa e pajisjeve dhe materialit shpenzues për punën e patrullave policore paraqet një hendikep në kryerjen efektive të detyrave në terren. Mosmbajtja e këtyre pajisjeve mund të ketë pasoja dhe të ndikojë negativisht në kryerjen e detyrave dhe arritjen e rezultateve në terren.

3.1.13. Është e njohur se sfida e sigurisë së objekteve mund të tejkalohet më lehtë me instalimin e sistemeve të video - mbikëqyrjes, sistemeve të alarmit kundër zjarrit, sistemeve të alarmit kundër thyerjes, kontrollit të përhershëm fizik të hyrjes dhe daljes, etj. PSO parasheh që kamerat duhet të vendosen në hyrje dhe dalje të objekteve, duhet të mbulojnë të gjitha sipërfaqet brenda dhe jashtë objektit dhe duhet të pozicionohen në mënyrë që të mos jenë shumë të ekspozuara. Kamerat janë të vendosura në vende kyçe brenda dhe jashtë objektit të stacionit dhe ky sistem monitorohet 24 orë nga një dhomë e veçantë përmes monitorit dhe administrohet nga DTIK-u. Sistemi është funksional dhe monitoron disa prej hapësirave brenda dhe jashtë objektit, përfshirë korridoret, dhomën e dëshmive, hyrje - daljet, qendrën e mbajtjes dhe hapësirën përreth objektit. Në sportelin hyrës të objektit mbahet regjistri i hyrje - daljeve, kurse gjatë hyrjes në hapësirat e stacionit vërehet prezenca e policit të sigurisë dhe i njëjti figuron edhe në orarin ditor të aktiviteteve (statiku). Stacioni ka Planin e reagimit emergjent dhe pajisjet për fikje të zjarrit, por që iu ka skaduar afati i përdorimit.

## 3.2. Performanca e Stacionit Policor në Podujevë

3.2.1. Stacioni Policor - Podujevë është i strukturuar në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Prishtinës dhe me Strukturën organizative të datës 28.02.2019, ka qenë i kategorizuar si stacion i kategorisë B. Me ndryshimet e bëra në vitin e kaluar, nga data 28.08.2020, funksionon si stacion i kategorisë A. Stacioni funksionon me tre sektorë: operativë, hetime dhe resurse. Në kuadër të operativës

<sup>8</sup> Stacioni Policor - Skenderaj, *Formular mbi inspektimin e automjeteve*, datë 11.03.2021.



funksionojnë ekipet reaguese A, B, C, D, sektorët A, B, C, D dhe Nënstacioni Policor - Orllan. Stacioni ka Qendrën e Mbajtjes me gjithë që strukturimi i fundit nuk parasheh një ndarje të tillë, edhe pse kur i ka takuar kategorisë B, Stacioni ka pasur Qendrën e Mbajtjes.

3.2.2. Struktura organizative parasheh që Stacioni Policor në Podujevë të ketë 121 punonjës, por pas verifikimit të listave të personelit, vërehet se Stacioni në fjalë ka 123 punonjës të uniformuar dhe shërbyes civil. Stacioni ka numër më të madh të të punësuarve krahasuar me Strukturën dhe aty vërejmë tejkalim të numrit për një (1) toger dhe nëntë (9) polic. Po ashtu, ka mungesë të tre (3) kapitenëve dhe pesë (5) rreshterëve. Janë identifikuar tre (3) togerë që ushtrojnë detyrat në pozita më të larta se që parashihen për gradat që mbajnë (Zëvendëskomandanti i stacionit ka gradën toger dhe ushtron detyrën e kapitenit, Shefi i Sektorit të Operativës ka gradën toger dhe ushtron detyrën e kapitenit dhe Shefi i Sektorit të Hetimeve ka gradën toger dhe ushtron detyrën e kapitenit). Nuk janë hasur raste kur pozitave ushtrohen me ushtrues detyre. Është hasur një (1) rast kur shërbyesi civil është i pasistemuar përshkak se nuk parashihet me strukturë, por që është i angazhuar në aktivitete tjera të stacionit.

Kategoria	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Shërbyes civil	Gjithsej
Planifikuar	1	3	4	15	85	13	121
Aktuale	1	0	5	10	94	13	123
Ndryshimi	0	-3	+1	-5	+9	0	+2

3.2.3. Inspektorët në ditën që kanë realizuar inspektimin kanë hasur se Stacioni ka organizuar orarin e punës varësisht nga natyra e punës së zyrtarëve dhe njësave. Shërbyesit civil punojnë në orarin e rregullt nga ora 08.00 deri në 16.00, kurse sektorët dhe ekipet reaguese punojnë në dy (2) përkatësisht në tre (3) ndërrime. Ekipet reaguese punojnë në ndërrime: 07.00 - 15.00, 15.00 - 23.00 dhe 23.00 - 07.00, kurse sektorët vetëm në dy të parat. Stacioni ka dy lloj orarësh, mujor dhe atë ditor. Gjatë inspektimit të realizuar në ndërrimin e paraditës së datës 01.04.2021, inspektorët kanë siguruar oraret ditore të angazhimeve nga mbikëqyrësi i ndërrimit dhe regjistrin e vijueshmërisë. Inspektorët kanë verifikuar ardhjen në punë, prezencën e personelit në stacion dhe atij në aktivitete patrulluese dhe hetimore. Sipas vlerësimeve të inspektorëve nga kapaciteti prej 51 punonjësve sa ishte paraparë të përfshihet në aktivitet, në ditën e inspektimit kanë qenë aktive 90% e këtyre kapaciteteve (46 punonjës), përshkak se pjesa tjetër ka qenë në mungesë për arsye të ndryshme (5 punonjës). Nga të dhënat e stacionit dhe verifikimi i prezencës, vërehet se regjistri i vijueshmërisë nuk është i plotë, ngase nuk ofron informacionin e nevojshëm mbi evidentimin dhe vijueshmërinë. Kurse, mungesat në punë janë deklaruar dhe vlerësuar si të arsyeshme.

Kategoria	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Shërbyes civil	Gjithsej
Të parapara	0	0	3	4	34	10	51
Aktiv	0	0	3	4	29	10	46
Mungesë	0	0	0	0	-5	0	-5

3.2.4. Në drejtimin operacional, inspektorët janë interesuar të njihen me planet operative që janë në zbatim. Inspektorët kanë siguruar se stacioni ka në fuqi 11 plane operative që ndërlidhen me

urdhrrat operativ qendror dhe planet e drejtorive rajonale<sup>9</sup>. Vihet në pah se Stacioni më 01.04.2021 ka planifikuar aktivitete në mbikëqyrjen e zbatimit të masave kundër Covid-19, përfshirë dhe pikat e kontrollit, patrullimet e rrugëve e shesheve, vizitë shkollave, etj. Në terren kanë qenë aktive pesë (5) patrulla me automjete dhe në këmbë duke realizuar aktivitetet patrullues dhe sektorial (B-101, B-102, EK-1, EK-2 dhe EK-3). Nga inspektimi i realizuar, një patrullë policore në ora 13.32 të datës 01.04.2021 është hasur në qytet në rrugën e Xhamisë (EK-1), patrulla e dytë është hasur në ora 12.40 në rrugën e Bulevardit (EK-3), patrulla e tretë është hasur në ora 12.45 në rrugën “Zahir Pajaziti” (B-101) dhe patrulla e katërt është tërhequr nga drejtuesit e stacionit që të jetë në përcjellje të një ceremonie varrimi të një personi të vdekur nga Covid-19 (B-102). Inspektorët kanë vlerësuar se patrullat policore janë gjendur në pikat e parapara dhe në përbërje të plotë.

3.2.5. Qendrat e komunikimit në stacione janë të obliguara për të mbajtur logun ditor të ngjarjeve. Stacioni mban logun ditor të ngjarjeve në formë fizike e elektronike. Stacioni Policor në Podujevë nuk praktikon mbajtjen e evidencave periodike mbi kohën e reagimit dhe inspektorët kanë bërë disa matje nga reagimet policore të siguruar nga logu i ngjarjeve ditore. Nga matjet e bëra mbi 15 reagime policore të datës 01.04.2021 dhe 31.03.2021, rezulton se koha mesatare e reagimit të njësisve policore në vendngjarje lidhur me rastet e raportuara sillet të jetë rreth 12 minuta.

3.2.6. Inspektorët kanë pasur interesim të njihen me procesin e raportimit të aktiviteteve brenda ndërrimit dhe për ndërrimin. Policia praktikon raportimin në fund të aktivitetit policor, kurse mbikëqyrësi raportet e të gjitha njësisve i përmbledhë në një raport, i cili me raportet e ndërrimeve tjera bëhet pjesë e raportit 24 orësh. Inspektorët kanë siguruar raportin e ndërrimit paraprak meqë ndërrimi i hasur ende nuk kishte përfunduar aktivitetin e planifikuar. Po ashtu, është siguruar edhe Raporti 24 orësh i situatës ditore për datën 31.03.2021. Është verifikuar përputhja e shënimeve ndërmjet raportit të ndërrimit dhe atij 24 orësh dhe vihet përfundimi se informatat e raporteve të ndërrimeve përfshihen në atë 24 orësh. Raporti 24 orësh pasqyron raportimin e një (1) incidenti kriminal të ndodhur në zonën e përgjegjësisë së Stacionit, shqiptimin e nëntë (9) gjobave të trafikut dhe 45 gjobave për moszbatim të masave kundër Covid-19.

3.2.7. Lidhur me procedimin e lëndëve, nga inspektimi i 14 mostrave të raporteve fillestare të incidenteve shihet që të gjitha rastet janë evidentuar në Librin e rasteve dhe në pesë (5) prej tyre është respektuar afati i përcaktuar për procedim tek Zyra e SIPK-ut. Nëntë (9) raporte nuk janë të nënshkruara nga komandanti i stacionit dhe nuk mund të dëshmohet respektimi i afatit prej 24 orëve për procedim të rasteve (2021-AF-0283, 2021-AF-0278, 2021-AF-0276, 2021-AF-0293, 2021-AF-0287, 2021-AF-0286, 2021-AF-0284, 2021-AF-0273 dhe 2021-AF-0277). Meqë lëndët para se të dorëzohen tek njësitë përgjegjëse për hetim, duhet evidentuar në databazën e SIPK-ut, ka qenë interesim i inspektorëve të verifikojnë nëse është kryer një evidentim i tillë. Verifikimi i lëndëve vë në pah se të gjitha lëndët e mostruara figurojnë në bazën e të dhënave të SIPK-ut<sup>10</sup>. Pranim - dorëzimi i rasteve ndërmjet Zyrës së SIPK dhe Sektorit të hetimeve realizohet përmes formularit të veçantë ku nënshkruhen palët. Kurse, Sektori i hetimeve regjistron lëndët në Librin e evidentimit të rasteve të Sektorit të hetimeve.

<sup>9</sup> Planet Operative: “Sezona dimërore”, “Parandalimi”, “Largimi i lëmshëkërkuesve”, “Kulti fetar”, “Unaza e çelikt”, “Dorëza”, “Perimetri”, “Siguria në trafik”, “Rrjeta”, “Siguria në shkolla” dhe Urdhri Operativ për Gadishmëri dhe Reagim për Corona Virusin Covid-19.

<sup>10</sup> 2021-AF-0308, 2021-AF-0309, 2021-AF-0310, 2021-AF-0311, 2021-AF-0283, 2021-AF-0278, 2021-AF-0272, 2021-AF-0276, 2021-AF-0293, 2021-AF-0287, 2021-AF-0286, 2021-AF-0284, 2021-AF-0273, 2021-AF-0277.

3.2.8. Krahasimi mbi zbulueshmërinë e rasteve të hapura, qoftë vepra penale apo incidente, gjatë vitit 2019 sillet të jetë rreth 56%, kurse në vitin 2020 shënohet një rënie e zbulueshmërisë në 53%. Numri i raporteve inteligjente të trajtuara dhe përpunuara nga Zyrtari i inteligjencës, të cilat janë përcjellë më pas tek DIA në vitin 2019 ka qenë tetë (8), derisa në vitin 2020 është 17 sosh. Me gjithë ngritjen e numrit të raporteve inteligjente 5x5x5, konsiderohet se numri i tyre është i ulët kur merret parasysh kategoria e stacionit.

3.2.9. Një nga fushat e inspektimit ka qenë edhe trajtimi i personave të ndaluar përkohësisht deri në gjashtë (6) orë dhe atyre të ndaluar në qendër të ndalimit deri në 48 orë. Gjatë kontrollit të hapësirave që shfrytëzohen për shoqërim apo ndalim të përkohshëm të personave, është vërejtur se ato përbëhen nga dhoma të intervistave ku mund të mbahen të ndaluarit deri në gjashtë (6) orë nën mbikëqyrje të zyrtarëve përgjegjës. Kurse, për personat e ndaluar deri në 48 orë është në funksion qendra e ndalimit. Gjatë inspektimit nuk është hasur në persona të ndaluar përkohësisht deri në gjashtë (6) orë, kurse të ndaluar në qendër ndalimi kanë qenë pesë (5) persona, që të gjithë me aktvendime mbi ndalimin për 48 orë, të lëshuar nga organi kompetent<sup>11</sup>. Të ndaluarit në mbajtje nuk kanë shprehur ndonjë pakënaqësi sa i përket trajtimit të tyre nga personeli i stacionit dhe stacioni ka ndarë racionet e ushqimit me rregull. Sa i përket kushteve fizike dhe të sigurisë në këtë Qendër, pesë (5) të ndaluarit janë sistemuar në tre (3) dhoma të ndalimit. Një dhomë e ndalimit nuk mbulohet me sistem funksional monitorimi dhe ka pasur një çeshme jofunksionale (dhoma nr. 1), kurse dhoma nr. 2 nuk ka pasur toalet dhe në mungesë të saj, të ndaluarit shfrytëzojnë toaletet tjera brenda stacionit. Dhomat janë mbajtur mirë në aspektin higjienik.

3.2.10. Gjatë inspektimit të shtatë (7) zyrtarëve policor të rastit në stacion ka rezultuar se të gjithë kanë qenë të pajisur me armë zjarrtare Glock 9x19 me nga dy karikatorë me nga 15 fishekë zjarr secili. Tre (3) zyrtarë policor nuk kanë qenë të pajisur me qeska për pastrim të armëve. Zyrtarët policor kanë qenë të pajisur me sprej kimik OC me afat, shufra dhe pranga të metalta. Sa i përket mirëmbajtjes së armëve, inspektimi ka nxjerrë në pah se të gjithë zyrtarët i kanë pasur armët e pastërta e të padëmtuara. Drejtuesit e stacionit kanë siguruar disa dokumente me të cilat pasqyrojnë se në baza të rregullta periodike realizojnë inspektime të armëve, municionit dhe pajisjeve brenda stacionit.<sup>12</sup>

3.2.11. Stacioni është i ngarkuar me tetë (8) automjete, por shtatë (7) prej tyre janë funksionale. Nga kontrolli i katër (4) automjeteve rezulton se ato kanë pasur çelës të rrotave, ngritëse mekanike apo hidraulike, gomë rezervë, aparat për fikje të zjarrit, trekëndësh dhe ndihmën e parë. Dy (2) automjete nuk kanë pasur jelek reflektues (Police-102-03 dhe Police-105-03). Është me rëndësi të potencohet se aparatet për fikje të zjarrit kanë qenë me afat të skaduar. Drejtuesit e stacionit kanë siguruar disa dokumente që pasqyrojnë se periodikisht realizojnë inspektime të automjeteve<sup>13</sup>. Dy (2) nga katër (4) automjetet janë hasur në gjendje jo të mirë higjienike sa i përket mirëmbajtjes së tyre (Police-105-03 dhe Police-211-03).

3.2.12. Inspektorët janë interesuar për t'u njohur me gjendjen reale se sa pajisen patrullat policore me mjete e pajisje pune. Asnjëra nga katër (4) automjetet patrulluese nuk kanë qenë të pajisura me matës të shpejtësisë (stacioni ka 2 radar). Vetëm tek njëri automjet patrullues është hasur një (1)

<sup>11</sup> Aktvendimet: PPS. nr. 35/2021, të datës 31.03.2021 dhe 2021-AB-0708, të datës 31.03.2021.

<sup>12</sup> Raportet e inspektimit të armëve të zjarrit (datë 15.02.2021, 11.02.2021 dhe 09.02.2021).

<sup>13</sup> Stacioni Policor - Skenderaj, *Formular i inspektimit mbi gjendjen e automjetit*, datë 25.03.2021 dhe 30.03.2021.

nga tre (3) alkootestet që ka stacioni (dy prej tyre janë jashtë përdorimi, ngase nuk janë kalibruar). Stacioni ka shtatë (7) kamera (aparate), por që nuk janë hasur tek automjetet e inspektuara. Konet e trafikut janë gjetur tek të gjitha automjetet e inspektuara. Shiriti për kufizimin e vendit të ngjarjes është hasur në të gjitha automjetet. Metri është hasur në një (1) automjet.

3.2.13. Lidhur me masat e sigurisë, sistemi i monitorimit mbulon perimetrin e jashtëm dhe të brendshëm të stacionit. Sistemi monitorohet 24 orë nga një dhomë e veçantë përmes monitorit, kurse administrohet nga DTIK. Sistemi i monitorimit është funksional dhe i njëjti monitoron disa prej hapësirave brenda dhe jashtë objektit, përfshirë korridoret e stacionit, dhomën e dëshmimeve, hyrje - daljet e stacionit, qendrën e mbajtjes dhe hapësirën përreth objektit. Në sportelin hyrës të objektit mbahet regjistri i hyrje - daljeve, kurse gjatë hyrjes në hapësirat e stacionit vërehet prezenca e policit të sigurisë dhe i njëjti figuron edhe në orarin ditor të aktiviteteve. Stacioni ka Planin e reagimit emergjent dhe pajisjet për fikje të zjarrit, por që iu ka skaduar afati i përdorimit.

### 3.3. Performanca e Stacionit Policor në Obiliq

3.3.1. Stacioni Policor - Obiliq është i strukturuar në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Prishtinës dhe me Strukturën organizative të datës 28.02.2019, funksionon si stacion i kategorisë B. Stacioni funksionon me tre (3) sektorë: operativë, hetime dhe resurse. Në kuadër të operativës funksionojnë ekipet reaguese A, B, C, D dhe sektorët A, B dhe C. Stacioni ka Qendrën e Mbajtjes, por nuk shfrytëzohet përshkak se nuk parashihet me strukturë (të ndaluarit deri në 48 orë dërgohen në Prishtinë).

3.3.2. Struktura organizative parasheh që Stacioni Policor në Podujevë të ketë 56 punonjës dhe pas verifikimit të listave të personelit, vërehet se Stacioni ka 63 punonjës, prej tyre 56 punonjës të uniformuar dhe shtatë (7) shërbyes civil. Stacioni ka numër më të madh të të punësuarve krahasuar me Strukturën dhe aty vërejmë tejkalim të numrit për 13 polic. Po ashtu, ka mungesë të një (1) togeri, dy (2) rreshterëve dhe tre (3) shërbyesve civil. Është identifikuar një (1) rreshter që ushtron detyrën në pozitë më të lartë se që parashihet për gradën që mbanë (Shefi i Operativës ka gradën rreshter dhe ushtron detyrën e togerit). Nuk janë hasur raste kur pozitrat ushtrohen me ushtrues detyre.

**Tabela 5 - Pasqyrë tabelore mbi kapacitetet e planifikuara dhe ato aktuale të burimeve njerëzore të Stacionit Policor në Obiliq (01.04.2021)**

Kategoria	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Shërbyes civil	Gjithsej
Planifikuar	1	2	9	34	10	56
Aktuale	1	1	7	47	7	63
Ndryshimi	0	-1	-2	+13	-3	+7

3.3.3. Inspektorët në ditën që kanë realizuar inspektimin kanë hasur se Stacioni ka organizuar orarin e punës varësisht nga natyra e punës së zyrtarëve dhe njësisve. Shërbyesit civil punojnë në orarin e rregullt nga ora 08.00 deri në 16.00, kurse sektorët dhe ekipet reaguese punojnë në dy (2) përkatësisht në tre (3) ndërrime. Ekipet reaguese punojnë në ndërrime: 07.00 - 15.00, 15.00 - 23.00 dhe 23.00 - 07.00, kurse sektorët vetëm në dy të parat. Stacioni ka dy lloj orarësh, mujor dhe atë ditor. Gjatë inspektimit të realizuar në ndërrimin e paraditës së datës 01.04.2021, inspektorët kanë siguruar oraret ditore të angazhimeve nga mbikëqyrësi i ndërrimit dhe regjistrin e vijueshmërisë.

Inspektorët kanë verifikuar ardhjen në punë, prezencën e personelit në stacion dhe atij në aktivitete patrulluese dhe hetimore. Sipas vlerësimeve të inspektorëve nga kapaciteti prej 29 punonjësve sa ishte paraparë të jetë i përfshirë në aktivitet, në ditën e inspektimit kanë qenë aktive 76% e këtyre kapaciteteve (22 punonjës), përshkak se pjesa tjetër ka qenë në mungesë për arsye të ndryshme (7 punonjës). Nga të dhënat e stacionit dhe verifikimi i prezencës, nuk është vërejtur të ketë pasur mospërputhje mbi vijueshmërinë, kurse mungesat janë deklaruar dhe vlerësuar si të arsyeshme (4 punonjës në pushim mjekësor, 2 në pushim vjetor dhe 1 në pushim të veçantë).

Kategoria	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Shërbyes civil	Gjithsej
Të parapara	1	1	3	19	5	29
Aktiv	1	1	2	13	5	22
Mungesë	0	0	-1	-6	0	-7

3.3.4. Në drejtimin operacional, inspektorët janë interesuar të njihen me planet operative që janë në zbatim. Inspektorët kanë siguruar se stacioni ka në fuqi gjashtë (6) plane operative që ndërlidhen me urdhrat operativ qendror dhe planet e drejtorive rajonale<sup>14</sup>. Në terren kanë qenë aktive dy (2) ekipe reauese si patrulla me automjet dhe në këmbë duke realizuar aktivitet patrullues (AK-101 dhe AK-102) dhe dy (2) ekipe me aktivitet sektorial. Nga inspektimi i realizuar, të dy (2) patrullat policore nga radhët e ekipeve reaguese, në ora 13.00 të datës 01.04.2021 janë hasur në qytet. Sipas informacionit të pranuar nga radiokomunikuesi, patrullat policore janë gjendur në pikat e parapara dhe në përbërje të plotë.

3.3.5. Stacioni mban logun ditor të ngjarjeve në formë fizike e elektronike. Stacioni Policor në Obiliq nuk praktikon mbajtjen e evidencave periodike mbi kohën e reagimit dhe inspektorët kanë bërë disa matje nga reagimet policore të siguruara nga raportet fillestare të incidenteve. Nga matjet e bëra mbi 23 mostra (reagime policore) të tre muajve të parë të këtij viti, rezulton se koha mesatare e reagimit të njërive policore në vendngjarje lidhur me rastet e raportuara sillet të jetë rreth 14 minuta.

3.3.6. Lidhur me raportimin, është siguruar raportin e ndërrimit paraprak me që ndërrimi i hasur ende nuk kishte përfunduar aktivitetin e planifikuar. Po ashtu, është siguruar edhe raporti 24 orësh i situatës ditore për datën 31.03.2021. Është verifikuar përputhja e shënimeve ndërmjet raportit të ndërrimit dhe atij 24 orësh dhe vihet përfundimi se informatat e raporteve të ndërrimeve përfshihen në atë 24 orësh. Raporti 24 orësh pasqyron raportimin e një (1) incidenti kriminal të ndodhur në zonën e përgjegjesisë së Stacionit, shqiptimin e katër (4) gjobave të trafikut dhe shtatë (7) gjobave për moszbatim të masave kundër Covid-19.

3.3.7. Nga inspektimi i 23 mostrave të raporteve fillestare të incidenteve shihet të gjitha rastet janë evidentuar në Librin e rasteve dhe është respektuar afati i përcaktuar për procedim tek Zyra e SIPK-ut<sup>15</sup>. Meqë lëndët para se të dorëzohen tek njësitë përgjegjëse për hetim, duhet evidentuar

<sup>14</sup> Planet Operative: "Mbulimi i zonave me popullësi të përzier", "Shtimi i masave të sigurisë", "Lëmshëkërkuesit", "Kulti", "Dorëza" dhe Urdhri Operativ për Gadishmëri dhe Reagim për Corona Virusin Covid-19.

<sup>15</sup> Raportet fillestare të incidenteve: 2021-AJ-0081, 2021-AJ-0082, 2021-AJ-0075, 2021-AJ-0077, 2021-AJ-0079, 2021-AJ-0080, 2021-AJ-0038, 2021-AJ-049, 2021-AJ-0051, 2021-AJ-052, 2021-AJ-053, 2021-AJ-0054, 2021-AJ-



në databazën e SIPK-ut, ka qenë interesim i inspektorëve të verifikojnë edhe nëse është kryer një evidentim i tillë. Verifikimi i lëndëve vë në pah se të gjitha lëndët e mostruara figurojnë në bazën e të dhënave të SIPK-ut. Pranim - dorëzimi i rasteve ndërmjet Zyrës së SIPK-ut dhe Sektorit të hetimeve realizohet përmes formularit të veçantë ku nënshkruhen palët. Kurse, Sektori i hetimeve regjistron lëndët në Librin e evidentimit të rasteve të Sektorit të hetimeve.

3.3.8. Krahasimi mbi zbulueshmërinë e rasteve të hapura, qoftë vepra penale apo incidente, gjatë vitit 2019 sillet të jetë rreth 61%, kurse në vitin 2020 shënohet një rënie e zbulueshmërisë në 59%. Numri i raporteve inteligjente të trajtuara dhe përpunuara nga Zyrtari i inteligjencës, të cilat janë përcjellë më pas tek DIA në vitin 2019 ka qenë 36, derisa në vitin 2020 është 8 sosh. Rënia e numrit të raporteve inteligjente 5x5x5 vlerësohet të ketë ardhur për shkak të situatës së krijuar nga pandemia me Covid-19.

3.3.9. Gjatë kontrollit të hapësirave që shfrytëzohen për shoqërim apo ndalim të përkohshëm të personave, është vërejtur se ato përbëhen nga dhoma të intervistave ku mund të mbahen të ndaluarit deri në gjashtë (6) orë nën mbikëqyrje të zyrtarëve përgjegjës. Kurse, personat e ndaluar deri në 48 orë dërgohen në Qendrën e ndalimit në Prishtinë. Gjatë inspektimit nuk është hasur në persona të ndaluar përkohësisht deri në gjashtë (6) orë dhe të ndaluar deri në 48 orë.

3.3.10. Gjatë inspektimit të pajimit të zyrtarëve policor me armë, municion dhe pajisje, për tetë (8) prej tyre që kanë rastisur në stacion ka rezultuar se kanë qenë të pajisur më armë zyrtare Glock 9x19 me nga dy karikatorë me nga 15 fishekë zyrtar secili, qeska për pastrim armësh, sprej kimik OC me afat, shufra dhe pranga të metalta. Sa i përket mirëmbajtjes së armëve, inspektimi ka nxjerrë në pah se të gjithë zyrtarët i kanë pasur armët e pastërta e të padëmtuara. Drejtuesit e stacionit kanë siguruar dokumente që pasqyrojnë se realizohen inspektime të vazhdueshme të këtyre pajisjeve.<sup>16</sup>

3.3.11. Stacioni është i ngarkuar me dhjetë (10) automjete policore, por vetëm pesë (5) prej tyre janë funksionale. Nga kontrolli i tyre rezulton se ato kanë pasur çelës të rrotave, ngritëse mekanike apo hidraulike, gomë rezervë, aparat për fikje të zjarrit, trekëndësh dhe ndihmën e parë. Një (1) automjet nuk ka pasur jelek reflektues (Police-129-05). Është me rëndësi të potencohet se aparatet për fikje të zjarrit kanë qenë me afat të skaduar. Drejtuesit e stacionit policor kanë siguruar disa dokumente, ku pasqyrojnë se periodikisht realizojnë inspektime të automjeteve<sup>17</sup>. Automjetet janë hasur në gjendje të mirë higjienike sa i përket mirëmbajtjes.

3.3.12. Inspektorët janë interesuar për t'u njohur me gjendjen reale se sa pajisen patrullat policore me mjete e pajisje pune. Asnjëra nga dy (2) patrullat policore të hasura në terren nuk kanë qenë të pajisura me matës të shpejtësisë (stacioni ka 1 radar). Tek asnjëri automjet patrullues nuk është hasur alkootesti (stacioni ka 2 alkooteste, prej të cilëve vetëm njëri është funksional). Stacioni ka dy (2) kamera (aparate), por që vetëm njëra prej tyre është funksionale. Konet e trafikut janë gjetur tek të gjitha automjetet e inspektuara. Shiriti për kufizimin e vëndit të ngjarjes është hasur në tre (3) nga pesë (5) automjetet e inspektuara. Metri është hasur vetëm në një automjet.

066, 2021-AJ-0069, 2021-AJ-0070, 2021-AJ-0001, 2021-AJ-0017, 2021-AJ-0083, 2021-AJ-0018, 2021-AJ-0019, 2021-AJ-0022, 2021-AJ-0087, 2021-AJ-0086.

<sup>16</sup> Stacioni Policor - Obiliq, *Inspektimi i pajisjeve të zyrtarëve policor*, datë 07.02.2021.

<sup>17</sup> Stacioni Policor - Obiliq, *Formulari i inspektimit për gjendjen e automjetit*, datë 28.03.2021 dhe 01.04.2021.

3.3.13. Lidhur me masat e sigurisë, sistemi i monitorimit mbulon perimetrin e jashtëm dhe të brendshëm të stacionit. Sistemi monitorohet 24 orë nga një dhomë e veçantë përmes monitorit, kurse administrohet nga DTIK. Sistemi i monitorimit është funksional dhe i njëjti monitoron disa prej hapësirave brenda dhe jashtë objektit, përfshirë korridoret e stacionit, dhomën e dëshmimeve, hyrje - daljet e stacionit, qendrën e mbajtjes dhe hapësira përreth objektit. Në sportelin hyrës të objektit mbahet regjistri i hyrje - daljeve, kurse gjatë hyrjes në hapësirat e stacionit vërehet prezenca e policit të sigurisë dhe i njëjti figuron edhe në orarin ditor të aktiviteteve. Stacioni ka Planin e reagimit emergjent dhe pajisjet për fikje të zjarrit, por që iu ka skaduar afati i përdorimit.

#### 4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

##### 4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 16.04.2021, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	IPK-ja i rekomandon Departamentit të Burimeve Njerëzore që të angazhohet në stabilizimin e strukturave të stacioneve me burimet e nevojshme konform Strukturës organizative, duke eliminuar mangësitë që lidhen me tejkalimet e numrit të të punësuarve, mospërputhjet gradë - pozitë dhe sistemimin e personelit të pasistemuar nga radhët e shërbyesve civil.	-I-	Grupi punues në nivelin e DPP është duke punuar në përgatitjen e strukturës së re organizative, duke përfshirë edhe të stacioneve policore.	
2.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor në Podujevë që të ushtrrojë mbikëqyrje të nevojshme për t'u siguruar se mbahet evidencë e rregullt dhe e plotë mbi vijueshmërinë në punë për gjithë personelin e stacionit.	-I-	Stacioni Policor - Podujevë: Kemi filluar me ndarjen e dy listave të hyrje - daljeve nga stacioni, duke evidentuar të gjitha hyrje - daljet e stafit dhe në të gjitha ndërrimet.	19.04.2021 Ora 08:00
3.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor në Skenderaj që të shtojë përpjekjet për eliminimin e vonesave në procedimin me kohë të rasteve tek Zyrtari i SIPK-ut brenda afatit prej 24 orësh konform Procedurës Standarde të Operimit për procedimin e lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit.	-I-	Stacioni Policor - Skenderaj: Ne piken 3.1.7. të cekur në draft raportin e inspektimit ceket se të gjitha rastet rezultojnë të regjistruara në SIPK, ndërsa poashtu ceket se janë hasur në vonesa të dorëzimit të katër rasteve brenda afatit 24h sipas PSO për të dorëzuar në SIPK (epurorët e SP Skenderaj si dhe zyrtari i SIPK në SP Skenderaj deklarojnë se gjatë kohës kur është kryer inspektimi të gjitha rastet kanë qenë të dorëzuara në SIPK brenda afatit kohor) me çrast edhe e keni cekur se janë të gjitha të regjistruara, POR nuk dimë se si ka ardhur deri të konkludimi se katër raste të cilat i keni specifikuar me të dhëna të rasteve kanë	Do të merret parasysh që rastet mos të vonohen në dorëzim jashtë afatit kohor sipas PSO, ku dhe do të ketë mbikëqyrje të shtuar nga Komandanti i SP Skenderaj

			rezultuar se jane dorëzuar me vonese? Pavarësisht kësaj, do te ketë mbikëqyrje te shtuar nga komandanti i SP Skenderaj ne evitimin e këtyre rasteve nese paraqiten vonesa.	
4.	IPK-ja i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor në Podujevë që çdoherë para se të procedohen rastet tek Zyrtari i SIPK-ul, të nënshkruhen dhe procedohen siç parashihet me Procedurën Standarde të Operimit për procedimin e lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit.	-I-	<u>Stacioni Policor - Podujevë:</u> Procedura standarde e operimit lidhur me procedimin e rasteve deri në SIPK, respektohet në plotni. Do të rrisim kujdesin që procedura të respektohet plotësisht.	Në vazhdimësi
5.	IPK-ja rekomandon komandantët e stacioneve policore në Skenderaj, Podujevë dhe Obiliq që të shtojnë angazhimet e zyrtarëve policor dhe atyre të inteligjencës në sigurimin e informatave në të shumta përmes kanaleve operative, drejt ofrimit të shërbimeve në të mira për qytetarët dhe ngritjes së nivelit të sigurisë.	-I-	<u>Stacioni Policor - Podujevë:</u> Me të pranuar rekomandimin kemi marr masat për angazhim të shtuar në pranimin, përpunimin dhe adresimin e informatave inteligjente në përputhje me strategjinë e policimit të bazuar në inteligjencë. <u>Stacioni Policor - Obiliq:</u> Menjëherë kam pasur një takim pune me Z/P të inteligjencës që të bashkëpunoi me Policimin në bashkësi, Hetimet, Njësit sektoriale. Përcjellja e personave të dyshuar me precedent penal për Terrorizëm dhe bashkimit të luftës në Siri. Vlerësimi i sigurisë në shkolla si dhe monitorimi i situatës në fshatra multi-etnike dërgimin e tyre në DIA në formë 5x5x5. Përpilimi i raporteve analitike Javore dhe Mujore. <u>Drejtoria Rajonale - Mitrovicë Jug:</u> Operativa rajonale ne suaza javore kërkon raportimet ne formën e vegante te cilët e posedojmë si Drejtori Rajonale rreth shkruarjes se informatave inteligjente dhe operative.	Në vazhdimësi



			<p>Ne kuadër të DRP Mitrovicë Jug u është përpiluar një udhëzues për informatat inteligjente, ku raportohet çdo javë nga stacionet/njësitet, dhe ku SP Skenderaj do të angazhohet në ngritjen e sigurimit të informatave inteligjente dhe operative. Tani do të aplikohet me tepër edhe Strategjia e Integruar për Intelgjencë dhe Polici në Bashkësi. Do të shfrytëzohen me tepër kompjuterët të cilët janë vendosur në dhomat e kujdestarisë ku kanë qasje të gjithë zyrtarët policor dhe enkas për shkruarje të raporteve inteligjente.</p>	
6.	<p>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore në Skenderaj, Podujevë dhe Obiliq që në bashkëpunim me Drejtorinë e Logjistikës, të sigurohen që pajisjet në automjete për fikjen e zjarrit, të jenë të kontrolluara dhe me afat.</p>	-I-	<p><u>Udhëheqësi i SHM - DRP Prishtinë</u> Është ngritur kërkesa në DPP – DMO. Në pritje.</p> <p><u>Drejtorja Rajonale - Mitrovicë Jug:</u> Me datën 02 Shkurt 2021 Udhëheqësi i Njesisë për Shërbime Mbështetëse të DRP Mitrovicë Jug ka bërë kërkesën për Servisim dhe Furnizim me 4 aparate kundër zjarrit për vetura të tipit Shkoda. Jemi në pritje të përfundimit të proceseve të kontraktimit/projekteve pranë Departamentit të Mbështetjes për të plotësuar rekomandimet në fjalë.</p> <p><u>Drejtorja e Menaxhimit të Objekteve:</u> Lidhur me pajisjet për fikjen e zjarrit, ju informojmë se është iniciuar kërkesa për lidhje të kontratës për servisim, rimbushje dhe furnizim me aparate kundër zjarrit për objektet dhe automjetet e PK-së. Në ndërkohë kjo kërkesë është kthyer për modifikime</p>	Në proces

			<p>përkatëse të kërkesës. Pas modifikimit është bërë ri inicimi i lëndës. Tani lënda është në proces të aprovimit të kërkesës për lidhje të kontratës. Menjëherë pas lidhjes së kontratës së re do të fillohet me aktivitetet përkatëse për servisim, rimbushje e furnizim të aparateve në objektet dhe automjetet e PK-së.</p>	
7.	<p>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore në Skenderaj, Podujevë dhe Obiliq, që të sigurohen që njësitë patrulluese në terren, të kenë në dispozicion pajisjet dhe mjetet e nevojshme për punë patrulluese, përfshirë matësit e shpejtësisë, alkootestet, aparatet (kamerat), etj.</p>	-II-	<p><u>Drejtoria Rajonale - Mitrovicë</u> <u>Jugu:</u> Me date 09 Nëntor 2020 Udhëheqësi I Njësisë për Shërbime Mbështetëse të DRP Mitrovicë Jug i ka përcjell kërkesën e SP Skenderaj, Drejtorit të Divizionit të Komunikacionit Rrugor Jeton Rexhepi dhe Drejtorit të DTIK se N/kolonel Gazmend Krasniqi për tu furnizuar si ne vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Një (1) Matës të shpejtësisë(Radar)</li> <li>➤ Një(1) Alkootest</li> <li>➤ Katër (4) Kamera digjitale</li> <li>➤ Tetë (8) Kompjuter</li> <li>➤ 30 copë bateri të kamerave digjitale.</li> </ul> <p>Me 28 Tetor 2020 nga Drejtori i Divizionit të Komunikacionit Rrugor N/kolonel Jeton Rexhepi është pranuar njoftimi se projekti për radar është në proces. Ndërsa kontrate valide nuk ka. Varësisht prej zhvillimeve me kohe do të jone të informuar të gjitha njësitë policore përkatëse. Jemi në pritje të përfundimit të proceseve të kontraktimit/projekteve pranë Divizionit të Komunikacionit Rrugor pranë DPP-se Departamentit të Mbështetjes për të plotësuar rekomandimet në fjalë.</p>	

			<p><u>Udhëheqësi i SHM DRP Prishtina</u>          Është ngritur kërkesa në DKRR dhe DTIK-të, në DPP. Në pritje</p> <p><u>Drejtoria e Teknologjisë Informative</u>          Në lidhje me furnizimin me kamera digjitale për nevoja të stacioneve policore, DTIK-u është në proces të realizimit të kërkesës për blerje të pajisjeve bazuar në planifikimin për këtë vit. Në momentin që do të bëhet furnizimi do të shpërndahen nëpër këto stacione policore bazuar në nevojat e këtyre stacioneve policore.</p>	Në proces
8.	<p>IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore në Skenderaj, Podujevë dhe Obiliq, që në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Objekteve, të sigurohen që pajisjet për fikjen e zjarrit të vendosura nëpër stacione, të jenë të kontrolluara dhe me afat.</p>	-I-	<p><u>Udhëheqësi i SHM DRP Prishtina</u>          Është ngritur kërkesa në DPP – DMO. Në pritje .</p> <p><u>Drejtoria Rajonale - Mitrovicë Jug</u>          Me date 01.Shkurt 2021 nga Shefi i Sektorit të Mirëmbajtjes DMO Zenel Telaku jemi njoftuar se kontrata për servisim, mbushje dhe furnizim me aparate kundër zjarrit ka skaduar dhe ne jemi duke përgatitur projektin për servisim, mbushje dhe furnizim me aparate kundër zjarrit për objekte dhe automjete. Me datën 02.Shkurt 2021 Udhëheqësi i Njesisë për Shërbime Mbështetëse të DRP Mitrovicë Jug i ka bërë kërkesën Shefit të Sektorit të Mirëmbajtjes DMO Zenel Telaku për Servisim dhe furnizim për të gjitha stacionet, njësit dhe objektin e DRP Mitrovicë Jug. (për nevoja të SP Skenderaj është kërkuar servisimi i 11aparateve për fikje të zjarrit dhe për furnizim me 03 aparate të ri kundërzjarri). Jemi në pritje të</p>	



		<p><i>përfundimit të proceseve të kontraktimit/projekteve pranë Departamentit të Mbështetjes për të plotësuar rekomandimet në fjalë.</i></p> <p><u><i>Drejtoria e Menaxhimit të Objekteve:</i></u></p> <p><i>Lidhur me pajisjet për fikjen e zjarrit, ju informojmë se është iniciuar kërkesa për lidhje të kontratës për servisim, rimbushje dhe furnizim me aparate kundër zjarrit për objektet e automjetet e PK-së. Në ndërkohë kjo kërkesë është kthyer për modifikime përkatëse të kërkesës. Pas modifikimit është bërë ri iniciimi i lëndës. Tani lënda është në proces të aprovimit të kërkesës për lidhje të kontratës. Menjëherë pas lidhjes së kontratës së re do të fillohet me aktivitetet përkatëse për servisim, rimbushje dhe furnizim të aparateve në objektet dhe automjetet e PK-së.</i></p>	<p><i>Në proces</i></p>
--	--	---	-------------------------